

VENDIM
Nr.354, datë 12.5.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, NË SHKOLLËN E LARTË
PRIVATE “SEVASTI&PARASHQEVI QIRIAZI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen, në shkollën e lartë private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të tretë, Master i Nivelit të Dytë (MND) në:

- a) “Administrim biznesi”;
- b) “Administrim publik”.

2.Këto programe studimi të ciklit të tretë realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë “Master i Nivelit të Dytë, (MND)”, përkatësisht, në:

- c) “Administrim biznesi”;
- d) “Administrim publik”.

3.Shkolla e lartë private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”, Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4.Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha